



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2533 / Prot.
2

Vlorë më, 12. 11. 2024

VENDIM
Nr. 43, datë 12.11.2024

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT, "MASTER I SHKENCAVE NË MARKETING DIXHITAL NË FAKULTETIN E EKONOMISË, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 49, 71, 75, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nenit 25 të Statutit të Uv-së, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Rektorit të UV-se, ardhur me shkresë 2536/22 prot, datë, 07.11.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 12.11.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Biznesit, në Fakultetin e Ekonomisë, për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit "Master i Shkencave në Marketing Dixhital", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Vendimi përcillet për miratim të mëtejshëm në MAS dhe QSHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA